



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria për Prokurim Publik

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: Grup i OE "ARMIRING" SHPK, me seli në Malishevë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën **05.10.2023**, merr këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e pasuksesshëm, të subjektit në procedurë: OE "ARMIRING" SHPK, me seli në Malishevë, në procedurën e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratis të Lumit Silnica dhe Lumit Llap", Nr.Prokurimi: VU644-23-9129-5-1-1, Nr. i brendshëm: VU644-23-120-511.
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Njoftimi për Kontratë të dt. **01.09.2023**, i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë për Prokurim Publik.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore të OE së lartpërmendur në Kërkesën për rishqyrtim, konstatoj se pretendimet e OE janë tërësisht të pabazuara, për faktin se i referohen Dosjes fillestare të tenderit (të datës 01.09.2023), e cila ka pësuar korrigjime në të gjitha pretendimet e parashtruara. Vlen të theksohet se Dosja e tenderit e datës 01.09.2023, dy herë është korrigjuar dhe publikuar në platformën elektronike me datën 11.09.2023 dhe 28.09.2023, nga A.K. duke inkorporuar në korrigjimet e Dosjes së Tenderit edhe pretendimet ankimore të parashtruesit të K.R.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se pretendimet ankimore të Ankuesit janë plotësisht të paargumentuara dhe për rrjedhojë të pa bazuara, andaj A.K. konstaton se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshe nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik
K.R. nr. 120/2023 - datë 02.10.2023

Drejtoria për Prokurim Publik


Alban Tahiraj - Drejtor

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës,
2. 1 x DPP-së, dhe
3. 1 x Arkivit (1 kopje)